



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.166/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale qw do tw mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN, me të cilën pretendon se kandidati për Kryetar të Komunës së Mitrovicës nga radhët e LDK-së, Safet Kamberi ka vendosur një poster në afërsi të shkollës fillore “Andon Zako Çajupi” në Mitrovicë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se billbordi në të cilin është vendosur fotoja e kandidatit të LDK-së për Kryetar të Komunës së Mitrovicës, është i vendosur në atë lokacion me leje të Komunës dhe është i dedikuar për reklamime të tilla gjatë fushatës. Më tutje LDK kërkon që ankesa e subjektit politik LVV të hidhet si e pa bazuar.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e BIRN, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye e posterit i vendosur në afërsi të shkollës, gjatë fushatës nuk është e ndaluar, por e ndaluar është dhe duhet të largohen në largësi prej 100 metra, 24 orë para hapjes së Qendrës së Votimit në ditën e votimit. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrues**

ZL. Anr.166/2017 më datën 12.10.2017.



**Kryesuese i Panelit  
Fijzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.